



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-I-23-0241**

***Në ankesën e***

**Paditësja/Ankuesja**

**D P**, Prishtinë

***kundër***

**E paditura**

**NSH KB "Liria"**, Bardhosh e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Asllan Krasniqi, gjyqtarë, duke vendosur sipas kërkesës së paditëses të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, AC-I-22-0119 të datës 16 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 05 dhjetor 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Kërkesa e paditëses hedhet poshtë si e papranueshme.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 26 shkurt 2014, paditësja për mes postës e dërgoi në DHPGJS një pliko, në të cilën ajo ka dërguar Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN144-0051 të datës

25.09.2013 me të cilin është refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës.

Me 08 tetor 2020, Shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-14-1199, ankesën e paditëses e konsideron si të tërhequr. Shkalla e parë e DHPGJS-së ka arsyetuar se në bazë të nenit 253.4 të LPK-së, paditësi e ka pas për detyrë që bashkë me ankesë të bashkëngjisë vërtetimin për pagesën e taksës gjyqësore. Gjykata me 03 korrik 2020, e ka lëshuar Urdhrin për paditësen për pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 20 euro, duke e paralajmëruar se në rast se nuk e paguan taksën gjyqësore, apo nuk paraqitë kërkesë në gjykatë për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, ankesa do të konsiderohet e tërhequr. Vërejtja është tentuar të dorëzohet dy herë, ndërsa raporti i postës është se adresa nuk është e saktë, andaj në bazë të nenin 116.1 të LPK-së paditësja ka qenë i obliguar që në rast të ndërrimit të adresës ta njoftoj menjëherë Gjykatën për adresën e re ku duhet të dorëzohen shkresat e lëndës, por që i njëjti këtë nuk e ka bërë. Andaj Gjykata pastaj Urdhrin për pagesën e taksës gjyqësore e ka vendosur në tabelën e shpalljeve të Gjykatës nga data 03.08.2020 e deri me 10.08 2020 dhe nga data 16.12.2020 e deri 25.12.2020, ku komunikimi i Gjykatës me ankuesen i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i ligjshëm. Tutje Shkalla e parë konstaton se paditësja/ankuesja nuk ka interes për çështjen juridike të saj, andaj ankesa konsiderohet e tërhequr.

Me 07 mars 2022, paditësja për mes postës e dërgoi në DHPGJS një ankesë kundër Aktvendimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-1199 të datës 08 tetor 2020, dhe paditësja në ankesë ka kërkuar që të prishet Aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Me datë 28 prill 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditëses duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, dhe e mbështet Aktvendimin e ankimuar të shkallës së parë të DHPGJS-së, duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Me 16 mars 2023, Kolegji i Apelit i DHPGJS, me Aktvendimin AC-I-22-0119, ankesën e paditëses e ka refuzuara si të pabazuar dhe ka vërtetuar Aktvendimin e shkallë së parë C-IV-14-1199 të datës 08 tetor 2020.

Me 30 mars 2023, paditësja ka paraqitur një kërkesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Apelit AC-I-22-0119, ku ka theksuar se ajo nuk ka qenë e lajmëruar me vërejtjet e gjykatës së shkallës së parë dhe se posa ka marr veshë për ngjarjen ajo është lajmëruara dhe e ka paguara taksën. Ka shtuar se ajo disa here është lajmëruar por nuk e di arsyen se pse nuk po shkojnë letrat. I ka propozuar Gjykatës që ti aprovet kërkesa e saj.

### **Arsyetimi ligjor**

Kërkesa e paditëses është e papranueshme.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Kolegji i Apelit vlerëson se sipas nenit 9, paragrafi 14 të Ligjit nr. 06/L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), të gjitha Aktgjykimet dhe Aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të formës së prerë dhe kundër tyre nuk mund të parashtrohet ankesë apo kërkesë për përsëritjen e procedurës.

Për më tepër LDHP nuk ofron asnjë mjet tjetër të jashtëzakonshëm kundër Aktgjykimeve/Aktvendimeve të tilla të formës së prerë të Kolegjit të Apelit (një mjet i tillë i jashtëzakonshëm nuk ishte i paraparë as me Ligjin paraprak përkatësisht nenin 10, paragrafi 14 i Ligjit Nr.04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe as me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 dhe as me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2008/6).

Kolegji i Apelit vëren se për lëndën në fjalë është parashtruar një kërkesë dhe Kolegji i Apelit vlerëson se kjo çështje tanimë është vendosur me Aktvendimin AC-I-22-

0119, të datës 16 mars 2023, Aktvendim ky i cili është i formës së prerë dhe ndaj të cilit Aktvendim nuk mund të parashtrohet kërkesë apo ankesë sepse e njëjta konsiderohet çështje e gjykuar.

Prandaj, kërkesa e paditëses e parashtruar ndaja Aktvendimit të Kolegjit të Apelit është e papranueshme dhe si i tillë hedhet poshtë.

Prandaj për arsyet e përmendura më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Taksat gjyqësore:**

Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 05 dhjetor 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtari kryesues \_\_\_\_\_